



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:262461
Datë: 14.05.2024
Numri i dokumentit: 05679568

C-IV-22-0413

Parashtruesi i kërkesës

N I, nga fshati L, Komuna e Vitisë

kundër

Pala kundërshtare

Agjencia Kosovare e Privatizimit- (AKP) (NTSH “Morava e Epërme” në likuidim), Rr. “Agim Ramadani” nr.23, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 14 maj 2024, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- I. Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar.**
- II. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit GJI104-0080 datë 22 nëntor 2013.**
- III. Secila palë i mbulon shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 27 dhjetor 2013, ankuesi parashtror kërkesë për rishqyrtimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (në tekstin e mëposhtëm AL) GJI104-0080 i datës 22 nëntor 2013, (në tekstin e mëposhtëm Vendimi), me të cilin i është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensim e pagave të papaguara në shumë prej 2,030.00 (dy zero tre zero) Euro, nga NTSH “Morava e Epërme” (në Likuidim).

Ankuesi pohon se nuk i është ndërprerë marrëdhënia e punës asnjëherë gjer me rastin e njoftimit të AKP me anë të letër pezullimit të datës 31 korrik 2007, mbi ndërprejen e marrëdhënia e punës.

Ankuesi kërkesën e tij, mbi kompensimin e pagave të pa-paguara, e mbështet në nenin 40 paragrafi 1.7 të Shtojcës së Ligjit për AKP.

Kërkesës i janë bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit.

AKP me 8 tetor 2018, parashtroj përgjigjen.

AKP kundërshton ankesën si të pabazuar. AKP pohon se ankuesi nuk ka afruar prova apo dëshmi në favor të kërkesës së tij për rishikim-ankesës. AKP më tutje pohon se bazuar në dispozitat e Shtojcës së Ligjit mbi AKP, lidhur me aplikimin e dispozitave ligjore të Ligjit për punën e bashkuar – LBP, kërkesa kreditore e ankueses është parashkruar. Nga të gjitha arsyet propozoj që kërkesa të refuzohet si e pabazuar dhe vendimi të vërtetohet.

Ankuesi parashtroj përgjigje, me 27 tetor 2018.

Ankuesi mbeti në tërësi si pranë kërkesës për rishqyrtim. Ankuesi, edhe me këtë përgjigje, kundërshtoj përgjigjen e AKP, si lidhur me pretendimet mbi parashkrimin dhe se i njëjti ka qen përfitues nga e drejta mbi pjesën e 20% nga privatizimi i NSH.

AKP parashtroj kundërpërgjigje me 1 nëntor 2018.

AKP mbeti në tërësi si pranë përgjigjes.

Duke vepruar sipas urdhrin të gjykatës, ankuesi me parashtresën e parashtruar pranë DHPGJS me 23 shtator 2020, parashtroj:

- Kopjen e vërtetimit të lëshuar me 24 nëntor 2010, nga AKP nga i cili shihet se ankuesi ka punuar pran NSH gjer me datën 25 korrik 2007, dhe
- Kopjen e Librezës së punës, e mbyllur me 25 korrik 2007.

Gjykata me Aktvendimin C-IV-13-4022 datë 5 tetor 2020 aprovoj kërkesën e ankuesit, shfuqizoj Vendimin e AL dhe obligoj AL që kërkesën kreditore ta rishqyrtoj.

Kolegji i Apelit i DHPGJS (KA), me Aktvendimin e saj AC-I-20-0464-A0001 datë 8 dhjetor 2022, aprovoj ankesën e AKP dhe anuloj Aktvendimin e gjykatës datë 5 tetor 2020.

KA në arsyetimin e vendimit, theksoj që gjykata duhet të vendos vet në meritat e ankesës së ankuesit.

Me 21 qershor 2023, gjykata lëshoi një urdhër për parashtruesin e kërkesës, përmes së cilit ju kërkua që të parashtrojë të gjitha faktet materiale që kanë të bëjnë me kërkesën ose ankesën dhe një listë provash që dëshmon se NSH i ka mbetur borxh pagat e papaguara, në shumën e kërkuar si dhe ju kërkua që të saktësojë periudhën kohore për pagat e papaguara

Duke vepruar sipas urdhrin, si më lartë, ankuesi parashtroj, kopjen e vërtetimit të lëshuar me 24 nëntor 2010, nga AKP nga i cili shihet se ankuesi ka punuar pran NSH gjer me datën 25 korrik 2007, dhe kopjen e Librezës së punës, e mbyllur me 25 korrik 2007, të cilat tani më ishin dorëzuar edhe me parashtresën e datës 23 shtator 2020.

AKP, bazuar në urdhrin e gjykatës parashtroj një listë të punëtorëve të cilët kanë pranuar njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Arsyetimi ligjor

Kërkesa për rishikim-ankesa konsiderohet e pabazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit për DHPGJS (ligji nr.06/L-086) në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Në rastin konkret bazuar sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS është obligim i palës, në këtë rast ankueses, që në parashtrirat e saj me shkrim, ankesën, të paraqesë një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe arsyetimit ligjor mbi të cilin vendos qëndrimin dhe argumentimin e saj. Në rastin kur pala pohon, në këtë rast ankuesja, të ekzistojë një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi.

Nga dispozita e cekur si më lartë, është obligim i ankuesit që të dëshmoj detyrimet ndaj tij, mbi mos pagesën e të ardhurave personale.

Vërtetimi dhe kopja e librezës së punës, nuk paraqesin dëshmi të mjaftueshme me të cilën ankuesi do të dëshmonte detyrimet e mbetura dhe të papaguara ndaj tij, në rastin konkret pagat, nga ana e NSH.

Lidhur me pagat e papaguara si dhe kompensimit, si rezultat i shitjes apo privatizimit apo edhe likuidimit nga ana e AKP, duke u bazuar në nenin 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 dhe 1.6.2 parashihet:

- a. përmbushja e kërkesave për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person, si dhe
- b. e drejta në kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në .

Tutje sipas nenit 40 paragrafi 1.7, të shtojcës së Ligjit për AKP, parashihet përmbushja e kërkesave siç janë: “kërkesat e pasiguruara, përfshirë kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë”.

Nga dispozitat e lartëcekura, mund të konkludohet se, punëtori/ja gëzon të drejtën në paga respektivisht dëmshpërblim nëse:

- a. pagat e punonjësit, në këtë rast ankuesit, nuk janë paguar;

Andaj nga të gjitha arsyet e cekura si më lart ankuesi nuk ka dëshmuar të drejtën e tij mbi kompensimin e pagave siç edhe parashihet sipas nenit 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 dhe 1.7 por edhe nuk ka dëshmuar ndonjë obligim tjetër ashtu siç parashihet sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS

Nga gjitha arsyet u vendos si në dispozitiv.

Shpenzimet gjyqësore

Ankuesi ka paguar taksat gjyqësore.

Në pajtim me nenin 62 të Ligjit për DHPGJS palët i bartin vetë shpenzimet gjyqësore.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar